

1. PAMJE E PËRGJITHSHME

Zhvillimet e bilancit të pagesave për vitin 2001 evidentojnë një rritje të madhe të transaksioneve korente, e cila është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve. Në nivel viti, totali i transaksioneve korente në vitin 2001 vlerësohet rreth 3.5 miliardë. Përveç shërbimeve, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente e tregtia e jashtme në mallra. Në fund të vitit llogaria korente u mbyll me një deficit prej 218.5 milionë dollarësh, 33.9 për qind më i lartë se ai i vitit 2000. Megjithatë është e nevojshme të evidentohet se bilanci korent përjashtuar transfertat shtetërore, vlerësohet 4 për qind më i ulët se një vit më parë.

Bilanci pozitiv i llogarisë kapitale dhe financiare mundi të financojë rreth 94 për qind të këtij deficiti.

Flukset hyrëse në mjete valutore, në formën e kapitaleve financiare, reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me 145 milionë dollarë.

Tabelë 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln usd).

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Llogaria Korente	18.8	31.4	36.6	-62.3	-253.7	-65.0	-132.9	-163.1	-218.5
Eksporti i mallrave fob	111.6	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4	304.6
Importi i mallrave fob	-620.5	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,076.4	-1,331.6
Bilanci tregtar	-508.9	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0	-1,027.0
Shërbimet: Kredi	76.3	83.1	98.2	127.3	67.9	86.6	266.7	448.1	533.5
Shërbimet: Debi	-165.3	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-129.3	-165.4	-430.0	-444.9
Të ardhurat: Kredi	19.8	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	162.5
Të ardhurat: Debi	-31.0	-41.4	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-13.4
Transfertat private	324.1	374.1	348.9	476.0	235.7	421.3	188.4	438.6	542.6
Transfertat shtetërore	303.9	117.1	128.5	83.4	29.0	82.6	165.0	94.4	28.1
Llogaria kapitale	0.0	21.6	389.5	4.9	2.1	31.1	67.5	78.2	108.4
Llogaria financiare	104.2	24.2	-414.5	49.6	140.7	16.0	36.8	182.5	128.2
Investime direkte	68.0	53.0	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	220.2
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	-23.4
Kapitale të tjera	36.2	-28.7	-484.5	-40.5	93.2	-29.0	-4.4	64.5	-80.6
Gabime dhe harresa	-24.7	-44.5	7.9	54.8	142.5	69.4	131.3	15.0	127.0
Bilanci i përgjithshëm	114.9	54.9	30.6	47.0	43.8	59.4	123.5	131.9	145.0
Rezerva & zëra të lidhur me të									
Mjetet e rezervës	-114.9	-54.9	-30.6	-47.0	-43.8	-59.9	-123.6	-131.9	-145.0
Përdor. kred. & huash nga fondi	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	12.0
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja
Financime të jashtëzakonshme
Për t'u përmendur									
Ndryshim i Rezervave	118.7	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-116.2
Efektet nga Kursi i Këmbimit	-3.8	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	1.5

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

Riaktivizimi në tremujorin e katërt të vitit të kaluar të krizës energjitike në vend, hapja e vitit 2001 me konjuktura të pafavorshme në çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare, si dhe hyrja në treg e operatorëve telefonikë AMC dhe Panafon-Vodafone, ishin faktorët kryesorë që çuan në rritjen e deficitit tregtar në vend, duke shkaktuar rritje të importeve në lëndë djegëse, makineri e pajisje si dhe rritje të kostos së prodhimit të brendshëm.

Zhvillimet e shpejta të tregtisë së jashtme gjatë viti 2001, pasqyruan rritje në importe dhe në eksporte. Volumi i përgjithshëm tregtar (llogaritur sipas metodikës së BoP, importi në çmim fob) u vlerësua në 1636 mln usd, me një rritje 23 për qind krahasuar me një vit më parë.

Sipas statistikave tregtare¹ eksporti arriti në nivelin 305 mln dollarë dhe importi në vlerë c.i.f 1325 mln dollarë, me rritje vjetore përkatësisht nivelet 19 dhe 24 për qind kundrejt një viti më parë.

Rritja 19 për qind në eksporte erdhi si rezultat i rritjes së volumit të mallrave të përpunuar të cilët vazhdojnë të mbajnë ekskluzivitetin e eksporteve tona me rreth 73 për qind të volumit të përgjithshëm të eksporteve. Gjithashtu, në rritje, edhe pse i vogël në volum, shfaqet eksporti nga prodhimi i brendshëm (me 8 për qind).

Tregtia e jashtme mbetet e orientuar drejt shkëmbimeve me vendet e komunitetit tregtar, me partnerë kryesorë brenda këtij grupi Italinë dhe Greqinë. Ndërkohë që, tregtia në rajon mbetet në nivele shumë të ulta.


Statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2001, tregojnë se *tregtia e jashtme në shërbime* (kryesisht shërbimet e turizmit) evidentohet si aktivitet me një rëndësi vitale për ekonominë shqiptare. Rolin kryesor në bilancin e shërbimeve e luajnë të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve të turizmit, të cilat zënë respektivisht rreth 83.6 dhe 57.8 për qind të eksportit dhe importit të shërbimeve. Vihet re një rritje e të ardhurave nga turizimi përgjatë gjithë vitit, kryesisht gjatë tremujorit të katërt (141.4 milionë dollarë). Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të

¹ Në analizën e mëposhtme importi dhe eksporti nuk përmbajnë vlerësimet e bëra nga BoP. Importi është në vlerë c.i.f.

turistëve që kanë vizituar Shqipërinë, kryesisht nga emigrantët që janë kthyer në shtëpitë e tyre.

Bilanci pozitiv i transaksioneve të “të ardhurave” në fund të vitit vlerësohet rreth 149 milionë dollarë amerikanë ose 39.5 për qind më i lartë se një vit më parë. E gjithë kjo rritje i dedikohet të ardhurave më të larta nga puna e punëtorëve sezonalë, e atyre kufitarë dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente.

Në fund të vitit bilanci pozitiv i transfertave korente u vlerësua rreth 571 milionë dollarë ose rreth 7 për qind më i lartë se në vitin 2000. Në shtesë të rritjes së dërgesave nga emigrantët dhe transfertave hyrëse shtetërore, rritja e suficitit në këtë kategori, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse.




Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE.

Mbulimi (financimi) i këtij deficiti korent është mundësuar nga flukset neto hyrëse të kapitaleve, të cilat në fund të vitit, regjistruan rreth 237 milionë dollarë amerikanë. Transfertat kapitale janë rritur me rreth 38.6 për qind kundrejt vitit të kaluar dhe vlerësohen rreth 108 milionë dollarë.

2. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i katërt regjistroi volumin më të lartë të transaksioneve korente për vitin 2001 (1.1 miliardë dollarë). Ky volum vlerësohet i rritur me 32.8 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe 26 për qind kundrejt periudhës korresponduese një vit më parë. Kjo rritje është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së jashtme dhe atyre të shërbimeve, të cilat këtë tremujor kapën shifrat më të larta përgjatë gjithë vitit 2001. Në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente. Të ardhurat korente, gjatë tremujorit të katërt, regjistruan 544 milionë dollarë dhe vlerësohen rreth 44 për qind më të larta se tremujori paraardhës dhe rreth 40.8 për qind kundrejt atij korrespondues të një viti më parë. Shpenzimet korente vlerësohen rreth 570 milionë dollarë dhe vlerësohen me një rritje prej 23.8 dhe 15.1 për qind respektivisht kundrejt tremujorit paraardhës dhe atij të njëjtë një vit më parë. Kështu deficiti korent rezulton 26.4 milionë dollarë ose rreth 3 herë më i vogël se tremujori i tretë i vitit 2001 dhe 4 herë më i vogël se tremujori i katërt i vitit 2000.



Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL


Në nivel viti, totali i transaksioneve korente vlerësohet rreth 3.5 miliardë dollarë ose 14.9 për qind më i lartë se në vitin paraardhës.

Të ardhurat korente vlerësohen 1.6 miliardë dollarë ose rreth 14 për qind më të larta se viti 2000. Shpenzimet korente vlerësohen rreth 1.9 miliardë dollarë ose rreth 16 për qind më të larta se viti paraardhës. Deficiti korent prej 218.5 milionë dollarë, 6 për qind të PBB-së nga 4.3 për qind që ishte në vitin 2000.

Megjithatë deficiti i llogarisë korente, përjashtuar transfertat shtetërore, këtë vit vlerësohet 3.6 për qind më i ulët se e një vit më parë duke regjistruar shifrën 250.9 milionë dollarë.

2.1 TREGTIA E JASHTME

Volumi i përgjithshëm i tregtisë së jashtme, në tremujorin e katërt të vitit, arriti në 480 milionë dollarë dhe përfaqëson volumin më të lartë të regjistruar në tremujorët paraardhës. Të dy komponentët tregtarë vlerësohen në rritje si ndaj tremujorit parardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.



Grafik 4. BILANCI TREGTAR (në mln usd).

Importi hyri në një volum prej 400.3 milionë dollarësh dhe përfaqëson 83 për qind të volumit tregtar të realizuar përgjatë tremujorit.

Me një rritje rreth 26 për qind kundrejt periudhës paraardhëse, importi gjatë këtij tremujori regjistroi, njëkohësisht edhe nivelin më të lartë të arritur që me hapjen e vendit drejt ekonomisë së tregut të lirë. Zhvillimet pozitive në fushën e investimeve të brendshme dhe të huaja, të cilat kanë rritur importin e makinerive dhe të pajisjeve, dhanë ndikimin kryesor në rritje të importeve.

Tabelë 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJORËVE PËR PERIUDHËN '94-'01 (në mln usd).

Periudha	Eksporte	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse	Importe	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse
T1 1994	28.0	-19.7	-98.6	-29.7
T2 1994	31.2	10.0	-136.9	22.1
T3 1994	30.9	0.6	-148.2	4.0
T4 1994	51.8	67.5	-171.6	12.8
T1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
T2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
T3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
T4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
T1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
T2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
T3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
T4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
T1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
T2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
T3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
T4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
T1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
T2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
T3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
T4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
T1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
T2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
T3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
T4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
T1 2000	61.7	-5.4	-227.3	-9.1
T2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
T3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
T4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
T1 2001	78.5	26.2	-285.4	-12.0
T2 2001	87.8	11.9	-328.1	15.0
T3 2001	58.5	-33.4	-317.7	-3.2
T4 2001	79.8	36.5	-400.3	26.0

Realizimi vjetor në importe vlerësohet 24 për qind më i lartë kundrejt një viti më parë.

Eksporti i mallrave, i vlerësuar në rreth 80 milionë dollarë, pasoi me një rritje prej 36 për qind tremujorin paraardhës duke realizuar, njëkohësisht, një nivel 28 për qind më të lartë kundrejt tremujorit të fundit të vitit 2000. Realizimi vjetor në eksporte, vlerësohet 19 për qind më i lartë kundrejt një viti më parë. Në mëse 88 për qind të saj kjo rritje i dedikohet rritjes së volumit të rieksperteve nga industria e përpunimit në vend.

Rritja e konsiderueshme në importe u shoqërua me thellimin e deficitit tregtar. Kështu, në fund të këtij tremujori ai regjistroi rreth 320 milionë dollarë, dhe vlerësohet deficiti më i lartë i arritur në vite.

Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv


Viti 2001 regjistroi zhvillime pozitive në fushën e përpunimit aktiv në vend. Me fillesa kryesisht në vitin '96, i cili përfaqëson vitin me hapjen e shumë subjekteve të industrisë përpunuese në vend, ky aktivitet kulmoi në vitin 2001,

TREGTIA	Volumi (në mln USD)			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
	T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2001/T3 2001	T4 2001/T42000
Totali i eksportit	61.7	58.5	79.8	100.0	100.0	100.0	36.5	29.4
nga të cilat:								
Eksport i zakonshëm	17.3	14.3	21.5	28.0	24.5	27.0	50.3	24.7
Riekспорт nga përpunimi aktiv	44.4	44.1	58.3	72.0	75.5	73.0	32.0	31.2
Totali i importit	334.4	319.9	399.6	100.0	100.0	100.0	24.9	19.5
nga të cilat:								
Import i përkohshëm për përpunim aktiv	44.4	42.6	57.7	13.3	13.3	14.4	35.3	30.0
Importe ndihma	3.7	2.0	5.2	1.1	0.6	1.3	158.4	38.1

gjatë të cilit u regjistruan volumet më të larta në eksportet dhe importet e kësaj industrie. Aktiviteti tregtar në fushën e përpunimit aktiv, i cili përfaqëson përgjithësisht aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj zë një vend të rëndësishëm në shkëmbimet tregtare. Gjatë tremujorit të katërt ato përfaqësuan 73 për qind në eksporte dhe 14 për qind në importe, duke regjistruar volume në rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.

Industria e përpunimit aktiv në vend është e përqendruar kryesisht në përpunimin e mallrave tekstilë e veshje këmbësh, të cilat së bashku përfaqësojnë 75 për qind të shkëmbimeve tregtare nga kjo industri. Italia përfaqëson investitorin kryesor në fushën e përpunimit aktiv në vend e ndjekur nga Greqia.

Eksperti për përpunim aktiv vlerësohet në rritje ndaj tremujorit parardhës, duke mbetur në tendencat normale të zhvillimeve të eksporteve të kësaj industrie: tremujori i tretë i vitit përkon me periudhën e pushimeve dhe shkëmbimet tregtare nga kjo industri shfaqen në rënie. Gjithashtu në rritje, këto eksporte vlerësohen kundrejt periudhës korresponduese të një viti më parë, duke bërë që realizimi vjetor i tyre për vitin 2001 të vlerësohet 24 për qind më i lartë ndaj një viti më parë si dhe të ruajë nivelin më të lartë të arritur në eksporte të kësaj industrie në vite.



Grafik 5. TENDENCA NË ECURINË E TREGTISË NGA FUSHA E PËRPUNIMIT AKTIV (indeks: T1 1996=100).

Rritje kundrejt një viti më parë kanë regjistruar eksportet në artikuj tekstilë e veshje këmbësh, të cilët zënë 86 për qind të volumit të eksportuar, gjithashtu rritje shënuan edhe eksportet në artikuj prej metali dhe eksportet nga industria ushqimore, edhe pse me peshë të vogël në eksportet e kësaj kategorie, përkatësisht 5 dhe 3 për qind.

Gjatë vitit 2001 **importi** për përpunim aktiv ka hyrë në një volum 21 për qind më të lartë kundrejt një viti më parë. Me volume në rritje kanë ardhur importet në tekstile dhe veshje këmbësh, lëkurë si dhe artikuj prej metali bazë, të cilat kryesojnë importet lëndë të parë për industrinë e përpunimit në vend, duke zënë përkatësisht 63, 14 dhe 7 për qind të volumit të importuar.

Importi dhe eksporti sipas grupmallrave

Importi tregtar, i vlerësuar në 1325 millionë dollarë për vitin 2001, e rriti me 24 për qind nivelin e tij të një viti më parë, duke regjistruar nivelin më të lartë të arritur që me hapjen e vendit drejt ekonomisë së tregut të lirë. Importi tregtar shënoi rritje përgjatë gjithë kategorive kryesore të mallrave, megjithatë ndikimin më të madh në rritje të volumit të përgjithshëm kundrejt një viti më parë e dha rritja e importeve në makineri e pajisje dhe importe në produkte minerale.

Tabelë 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd)

HS	GRUPMALLRA	Volumi			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2001/T3 2001	T4 2001/T4 2000
I	Kafshet e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	8.3	6.5	9.4	2.5	2.0	2.4	44.3	13.4
II	Produktet vegjetale	24.8	20.3	28.5	7.5	6.4	7.2	40.3	15.1
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	5.4	3.8	7.6	1.6	1.2	1.9	101.1	41.6
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	24.9	28.9	29.0	7.5	9.1	7.3	0.2	16.5
V	Produktet minerale	52.7	42.5	53.4	15.9	13.4	13.5	25.5	1.3
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	14.1	18.5	17.7	4.3	5.8	4.5	-4.6	25.3
VII	Plastikat; gomat dhe arikujt e tyre	8.5	10.0	10.3	2.6	3.1	2.6	3.4	21.9
VIII	Lekurat e paperpunuara e të perpunuara, artikujt e tyre	5.4	6.8	8.1	1.6	2.1	2.0	19.2	49.8
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	2.9	3.2	3.4	0.9	1.0	0.9	8.3	19.1
X	Brumi i drurit, mbetjet e letres, letra, kartoni art. të tyre	5.7	5.2	5.5	1.7	1.6	1.4	6.2	-2.7
XI	Tekstilet dhe artikujt tekstile	33.8	30.1	41.7	10.2	9.5	10.6	38.6	23.1
XII	Veshjet e kembeve, të kokës, cadrat, lule artificiale	10.5	9.4	14.2	3.2	3.0	3.6	50.6	34.3
XIII	Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	12.0	13.0	14.6	3.6	4.1	3.7	12.3	21.7
XIV	Perlat; gure e metalet e çmuar; bizhuteri; monella	0.5	0.1	0.1	0.2	0.0	0.0	155.7	-71.8
XV	Metalet baze dhe artikujt prej tyre	29.0	29.8	39.1	8.8	9.4	9.9	31.4	34.9
XVI	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	59.7	60.9	77.8	18.1	19.2	19.7	27.6	30.3
XVII	Mjete transporti, avjone, anije, pajisje shoqeruese transp.	18.3	16.0	18.1	5.5	5.0	4.6	13.1	-1.2
XVIII	Instrumente e aparate optike; ore; instrum. muzikore	6.4	6.3	4.9	1.9	2.0	1.3	-21.6	-23.3
XIX	Armet e municione; pjesët e plotsuesit e tyre	0.3	0.1	0.2	0.1	0.0	0.1	124.5	-9.5
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	7.6	6.6	11.0	2.3	2.1	2.8	65.3	43.8
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikitet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	TOTALI	330.6	317.9	394.5	100.0	100.0	100.0	24.1	19.3

Gjithashtu, zvogëlimi i evazionit fiskal, gjykuar nga rritja e çdoganimeve të mallrave me akcisë, ka kontribuar në rritje të volumit të importeve.

Zhvillimet pozitive në fushën e investimeve në vend patën për efekt rritje të importit tregtar përgjatë vitit. Hyrja në treg e operatorëve telefonikë AMC dhe Panafon Vodafon, të cilët që nga gjysma e dytë e viti të kaluar, filluan mbulimin gjeografik të Shqipërisë me valë telefonike, solli për pasojë importe të larta në zërin makineri e pajisje (kryesisht importe në antena për valë telefonike e gjeneratorë elektrikë), të cilat vlerësohen 65 për qind më të larta kundrejt një viti më parë. Konjuktura të pafavorshme në çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare, shkaktoi rritje të importeve në lëndë djegëse, gjithashtu, kriza energjitike, e vazhdueshme edhe gjatë këtij viti, sollën importe të larta në produkte minerale me rreth 29 për qind kundrejt një viti më parë.

Ritmet e ngadalta të prodhimit bujqësor, kryesisht në gjysmën e dytë të vitit, ndikuan në rritje të importeve në produkte vegjetale. Këtë vit, ato vlerësohen 16 për qind më të larta krahasuar me një vit më parë.

Gjithashtu në rritje, shfaqen importet në metale dhe artikujt prej metali. I ardhur me tendenca në rritje përgjatë tremujorëve të vitit, importi vjetor i këtij grupmali vlerësohet 34 për qind më i lartë kundrejt vitit parardhës. Ndër importet brenda këtij grupmali përmendim importet e hekurit, të çelikut dhe artikujt prej gize.

Eksporti tregtar paraqitet me rritje si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj periudhës korresponduese të vitit 2000. Ecuria e eksporteve është e varur nga zhvillimet në industrinë e përpunimit aktiv në vend, eksportet e të cilës përfaqësojnë mëse 2/3 e volumit të përgjithshëm.

Eksporti nga prodhimi i brendshëm mbetet josingjektiv në ecurinë e eksporteve tona. Për vitin 2001 ai përfaqësoi vetëm 27 për qind të volumit të përgjithshëm të eksportit dhe prezantohet në rritje kundrejt një viti më parë, rreth 8 për qind. Rritja ka ardhur kryesisht nga rritja e volumit të eksporteve në bimë medicinale, lëkurë dhe në artikuj druri. Realizimi vjetor i eksporteve të duhanit vlerësohet 25

për qind më i ulët se një vit më parë. Eksporti në karburante thuajse ka ruajtur nivelin e vitit parardhës duke u shfaqur lehtë në rritje, 3 për qind.

Tabelë 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE (në milionë usd).

HS	GRUPMALLRA	Volumi			Pesha (%)			Ndryshimi (%)	
		T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2000	T3 2001	T4 2001	T4 2001/T3 2001	T4 2001/T4 2000
I	Kafshet e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	0.2	0.7	0.5	0.4	1.2	0.6	-37.4	94.1
II	Produktet vegjetale	3.0	3.1	3.6	4.9	5.2	4.5	17.3	18.3
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	3.6	3.5	5.2	5.8	6.1	6.6	47.7	46.3
V	Produktet minerale	0.5	0.5	0.9	0.8	0.9	1.1	69.9	79.2
VI	Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	0.5	0.6	1.2	0.8	1.1	1.5	93.1	150.1
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	0.1	0.1	0.4	0.2	0.2	0.6	293.9	262.3
VIII	Lekurat e paperpunuara e të perpunuara, artikujt e tyre	2.4	2.1	2.3	4.0	3.6	2.8	8.2	-7.1
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	1.9	2.1	2.5	3.1	3.7	3.1	17.2	32.3
X	Brumi i drurit, mbetjet e letres, letra, kartoni art. të tyre	0.7	0.3	0.5	1.1	0.6	0.6	46.4	-27.1
XI	Tekstilet dhe artikujt tekstile	22.0	24.4	30.3	35.7	41.8	37.9	23.9	37.6
XII	Veshjet e këmbeve, të kokës, cadrat, lule artificiale	18.1	15.0	22.5	29.3	25.6	28.2	50.3	24.7
XIII	Art. prej guri, allicie, cimentoje; qeramike; qelq	0.1	0.3	0.9	0.2	0.4	1.1	242.5	670.4
XIV	Perlat; gure e metalet e çmuar; bizhuteri; monella	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	-8.4	-19.0
XV	Metalet baze dhe artikujt prej tyre	5.3	3.5	5.6	8.7	6.0	7.0	61.4	5.1
XVI	Makinëri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	0.9	0.7	1.7	1.4	1.1	2.1	157.6	100.1
XVII	Mjete transporti, avjone, anije, pajisje shoqeruese transp.	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	8.9	55.6
XVIII	Instrumente e aparate optike; ore; instrum. muzikore	0.0	0.0	0.2	0.1	0.0	0.2	793.8	334.3
XIX	Armet e municione; pjesët e plotsuesit e tyre	0.6	0.4	0.0	0.9	0.7	0.0	-99.6	-99.7
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	1.5	0.8	1.4	2.4	1.4	1.8	69.5	-3.3
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikitet	0.1	0.1	0.0	0.2	0.2	0.0
	TOTALI	61.7	58.5	79.8	100.0	100.0	100.0	36.5	29.4

Box. EKSPORTI I BRENDSHËM

Eksporti i brendshëm shqiptar konsiderohet i pazhvilluar. Gjerësisht ai përfaqësohet nga produkte bujqësore. Eksportet industriale kanë humbur rëndësinë e tyre që me falimentimin e ndërmarrjeve shtetërore. Mineralet kryesore, që tradicionalisht janë prodhuar në Shqipëri, kanë qenë kromi, bakri, ferrokromi, hekurnikel, si dhe produktet nga rafineria e naftës, të cilat deri në mesin e viteve '90 kanë përbërë një komponent dominues në të ardhurat nga shkëmbimet e huaja. Nën ekonominë e centralizuar, kryesisht nga fundi i viteve '70 deri në vitin 1990, prodhimi në minierat e kromit ishte komponenti më i rëndësishëm në industrinë minerale në vend. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria renditej e dyta në botë përsa i përket eksportit të këtij minerali (pas Afrikës së Jugut) dhe e treta për prodhimin e tij (pas Afrikës së Jugut dhe Bashkimit Sovjetik). Në vitin 1999 prodhimi i kromit ra ndjeshëm, me 47 për qind krahasuar me atë të vitit 1998. Kriza që kaloi industria nxjerrëse e kromit, si pasojë e grevave të vazhdueshme që goditën këtë industri, ndikoi negativisht në realizimin e eksportit të këtij minerali edhe gjatë viteve në vazhdim.


Prodhimi i bakrit në vend arriti nivelin e tij më të lartë rreth fundit të viteve '80. Në vitin 1999 prodhimi i mineralit të bakrit ra me rreth 37 për qind kundrejt vitit parardhës, prodhimi bakrit të pastruar ra ndjeshëm me 70 për qind dhe ai i bakrit kabëll dhe tel ndoqi rënien, e cila kish filluar që në vitin 1993.

Në të kaluarën prodhimi i energjisë elektrike, gazit natyror dhe naftës si dhe konsumi i ulët i karburanteve në vend e bënin Shqipërinë eksportues neto në energji. Reduktimi i prodhimit të energjisë elektrike rezultoi disa viteve thatësire, rënia në prodhimin e naftës si dhe rritja e nevojave të brendshme për energji elektrike, bënë që Shqipëria të humbi statusin e saj si eksportues neto në këtë sektor.

Rënia drastike e eksporteve në minerale vlerësohet faktori i vetëm, që ndikoi në uljen e volumit të eksportit të brendshëm, duke sjellë njëkohësisht dhe ndryshim në strukturën e tyre. Ka humbur ndjeshëm në peshë kategoria materiale të papërpunuara, e përfaqësuar kryesisht nga eksportet në minerale dhe kategoria lëndë djegëse, në të cilën përfshihet edhe eksporti i energjisë elektrike.

KODI	PERSHKRIMI	1996	2001
0	Ushqime dhe kafshe të gjalla	6	7
1	Pije dhe duhan	8	8
2	Materiale të paperunuara	22	14
3	Lende djegëse	23	5
4	Yndyrera bimore dhe shtazore	4	0
5	Produkte kimike	2	3
6	Mallra të perpunuara	28	51
7	Makineri dhe pajisje	2	6
8	Mallra të tjera të perpunuara	5	6
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	0	0
TOTAL		100	100

Tabela. Struktura ne eksporte nga prodhimi i brendshem.



Grafik. Ecuria e eksportit nga prodhimi i brendshem, ne mln USD.

Partnerët tregtarë

Aktiviteti tregtar i Shqipërisë me botën zhvillohet me orientimin kryesor vendet e Bashkimit Europian. Mëse 80 për qind e transaksioneve tregtare, përgjatë vitit 2001, janë kryer me vendet e BE-së. Gjatë këtij viti, shkëmbimet tregtare erdhën në rritje në të dyja drejtimet si në importe ashtu edhe në eksporte, duke e rritur nivelin e përgjithshëm të transaksioneve tregtare me këtë grupim në 23 për qind më të lartë kundrejt një viti më parë.


Mëse 66 për qind e volumit të përgjithshëm të transaksioneve tregtare të vendit për vitin 2001, është e përqenduar në shkëmbime me dy shtete europiane, Itali (40 për qind) dhe Greqi (26 për qind). Viti ka intensifikuar shkëmbimet tregtare me këto dy vende duke regjistruar nivele të larta në të dy komponentët tregtarë. Rreth 71 për qind e eksporteve shqiptare këtë vit pati për destinacion Italinë, njëkohësisht 33 për qind e importeve kanë ardhur nga ky vend, duke regjistruar rritje kundrejt vitit të mëparshëm përkatësisht 19 dhe 12 për qind.

Greqia ka treguar interesim për tregun shqiptar. Tregtia me këtë vend ka ardhur me tendenca në rritje përgjatë viteve (duke përjashtuar periudhën *shock* që kaloi vendi në vitin 1997, shih. Grafiku. 6). Hyrja e Greqisë si investitor në operatorët e telefonisë shqiptare, i dha një impuls pozitiv intensifikimit të shkëmbimeve tregtare me këtë vend. Këtë vit 29 për qind e importeve dhe 13 për qind në eksporte perfaqësohen nga Greqia, Eksporti dhe importi me këto shtet u rrit respektivisht me 29 dhe 26 për qind.

Tregtia me vendet e Rajonit² zë 13 për qind të totalit të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën. Shkëmbimet në rajon janë më të fokusuara në krahun e importeve. Tregtia në rajon prezantohet me 15 për qind të volumit të importuar dhe 6 për qind të volumit eksportuar. Në importe shkëmbimet kryhen në masën më të madhe me Turqinë, Bullgarinë dhe Sloveninë. Në eksporte shkëmbimet

² Në këtë grupim përfshihen Bullgaria, Bosnia Hercegovina, Kroacia, Jugosllavia (përfshi Mali i Zi dhe Kosovë), Maqedonia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia.

kryhen me Republikën Jugoslave (përfshihet Mali i Zi dhe Kosova), si dhe me Maqedoninë.



Grafik 6. TENDENCA E SHKËMBIMEVE TREGTARE (NË VOLUM EKSPORT + IMPORT) TË SHQIPËRISË ME PARTNERËT KRYESORË. (INDEKS: 1996=100).


E karakterizuar nga tendenca të theksuara në rritje përgjatë tre viteve të fundit, ka ardhur tregtia me Turqinë. Turqia tashmë pozicionohet e treta ndër partnerët tregtarë të Shqipërisë me botën, me 5 për qind të volumit të përgjithshëm tregtar për vitin 2001. Intensifikimi i shkëmbimeve tregtare me Turqinë është realizuar vetëm në krahun e importeve, ndërkohë që, i dobët mbetet ndikimi i saj në eksportet shqiptare. Zhvlerësimi i Lira-s pas krizës që kaloi ekonomia turke në nëntor të vitit 2000 dhe në shkurt të vitit 2001, ndikoi në rritje të ndjeshme të importeve me këtë vend, rreth 39 për qind krahasuar me vitin paraardhës.

Turqia është investitor në metalurgjinë e përpunimit të metaleve në vend (Kurum Elbasan). Kështu, në masë të konsiderueshme importohet lëndë e parë në gjysmë produkte gize e çeliku.

2.2 SHËRBIMET

Fundviti 2001 u mbyll me një suficit të llogarisë së shërbimeve prej 28.5 milionë dollarësh dhe vlerësohet rreth 61 për qind më i lartë se tremujori pararardhës, ndërkohë që tremujori korrespondues një vit më parë regjistroi deficit.

Në nivel viti transaksionet e shërbimeve u mbyllën me një bilanc pozitiv prej 88.6 milionësh, ndërkohë që viti 2000 ka regjistruar vetëm 20 për qind të tyre.



Grafik 5. BILANCI I SHËRBIMEVE.

Kështu, eksporti i shërbimeve (rreth 533.5 milionë dollarë) vlerësohet rreth 19 për qind më i lartë vitit paraardhës. Importi i shërbimeve, regjistroi rreth 445 milionë dollarë dhe vlerësohet i rritur kundrejt vitit të kaluar me 34.6 për qind.

Treguesi kryesor i bilancit të shërbimeve, aktiviteti i turizmit, sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, regjistron një rritje të konsiderueshme si në të ardhura (eksport shërbimi) ashtu edhe në shpenzime (import shërbimi). Kështu, eksporti i shërbimeve të aktivitetit të turizmit vlerësohet 446 milionë dollarë, shifër kjo rreth 47 për qind më e lartë se eksporti i mallrave, ndërkohë që shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 257 milionë dollarë amerikanë ose rreth 42 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Rrjedhimisht, në fund të vitit bilanci pozitiv i këtyre shërbimeve vlerësohej në 189 milionë dollarë amerikanë. Ashtu siç pritej, rritja e vëllimit të importit ka shkatuar rritjen e

importit të shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit. Importi i shërbimeve të transportit vlerësohet rreth 107 milionë dollarë ose rreth 13.8 për qind më i lartë se ai i vitit 2000, ndërkohë që importi i shërbimeve të sigurimit (rreth 43 milionë dollarë) është rritur rreth 26.6 për qind. Këto kategori shërbimesh kanë dominuar mbi transaksionet e tjera të shërbimeve.

Kategoria “shërbimet e tjera” ka regjistruar një suficit prej 34 milionë dollarësh ose 2.9 herë më të lartë se në 2000. Kjo rritje është mundësuar sidomos prej rritjes së të ardhurave kryesisht nga zhvillimi i shërbimeve të telefonisë. Megjithatë, roli i tyre në zhvillimet e tregtisë së shërbimeve mbetet modest dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm.

2.3 TË ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave gjatë tremujorit të katërt (44.6 milionë dollarë) vlerësohet i rritur si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj atij korrespondues një vit më parë, respektivisht me 12 dhe 44 për qind. Të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë, të cilat zënë 53 për qind të totalit kanë ndikuar ndjeshëm në këtë rritje.

Në nivel viti, bilanci i të ardhurave regjistroi rreth 149 milionë dollarë. Ky suficit vlerësohet me një rritje prej rreth 39.5 për qind kundrejt vitit të kaluar.


Të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë, këtë vit pësuan një rritje kundrejt vitit të kaluar prej 26 për qind duke regjistruar shifrën 84.4 milionë dollarë. Të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar regjistrojnë rreth 75 milionë dollarë dhe janë rritur rreth 1.5 herë nga viti 2000, rritje kjo si rrjedhojë e rritjes së depozitave tona në bankat dhe në institucionet e huaja jorezidente.

Ndërkohë, të ardhurat e dala jashtë në formën e interesave të paguar për depozitat e jorezidentve në sistemin tonë bankar si dhe interesave të borxhit të

jashtëm, regjistrojnë rreth 13.4 milionë dollarë (rreth 47 për qind më të larta se një vit më parë).

2.4 TRANSFERTAT

Transfertat korente, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2001, regjistruan vlerën më të lartë përgjatë vitit (221 milionë dollarë) dhe ka mbuluar rreth 69 për qind të deficitit tregtar. Kjo rritje erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së transfertave hyrëse kryesisht nga të ardhurat nga emigrantët, të cilat kanë kapur shifrën 235.5 milionë dollarë ose 1.8 herë më të larta se tremujori paraardhës.



Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE .

Në nivel viti, bilanci i transfertave korente u mbyll me një suficit prej rreth 571 milionë dollarësh. Ky suficit, megjithëse vlerësohet rreth 7 për qind më i lartë se viti paraardhës, ka mbuluar rreth 55.6 për qind të deficitit tregtar të mallrave ose rreth 9 pikë përqindje më pak se në vitin e kaluar, kjo si pasojë e rritjes së madhe të deficitit tregtar.

Dërgesat e emigrantëve për vitin 2001 vlerësohen rreth 15.8 për qind më të larta se në vitin 2000. Rritja e këtyre transfertave pasqyrohet në të gjithë tremujorët, kryesisht në tremujorin e katërt (235 milionë dollarë). Kjo rritje e fluksit të transfertave hyrëse, ka qenë mëse e mjaftueshme për të mbuluar rënien në

zërat e transfertave shtetërore, të cilët këtë vit vlerësohen vetëm 33 për qind e atyre të një viti më parë. Ndryshe nga viti i kaluar, kur transfertat shtetërore dominoheshin nga ndihmat në *cash* (59 për qind), në strukturën e transfertave shtetërore në vitin 2001, kanë mbizotëruar transfertat asistencë teknike, të cilat përfaqësojnë rreth 56 për qind të totalit të këtyre transfertave. Në shtesë të rritjes së dërgesave nga emigrantët dhe të transfertave hyrëse shtetërore, rritja e suficitit të bilancit në këtë kategori, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse.

Rritja e transfertave korente është shoqëruar, gjithashtu, nga rritje e transfertave kapitale.

3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE


Tremujori i katërt i vitit regjistroi një fluks neto kapitalesh prej 40.2 milionë dollarësh. Megjithëse transfertat e kapitalit (37.5) janë rritur me 39 për qind, flukset neto të kapitalit janë 25 për qind më të ulëta se tremujorin e kaluar. Kjo për arsye se llogaria financiare ka regjistruar një rënie prej rreth 9.8 herë. Kjo rënie vjen si rrjedhojë e rritjes së mjetet tona jashtë, të cilat pothuajse kanë balancuar detyrimet tona financiare.

Bilanci pozitiv i llogarisë kapitale dhe financiare, në fund të vitit 2001, vlerësohet rreth 236.6 milionë dollarë dhe ka financuar plotësisht deficitin e llogarisë korente. Krahasuar me vitin paraardhës ky suficit ka rënë me rreth 16 për qind.

3.2 DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare janë rritur me rreth 108.8 milionë dollarë ose 30 për qind më të larta se ato të tremujorit të kaluar. Në nivel viti, detyrimet financiare të ekonomisë shqiptare, u rritën rreth 347 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet rreth 1.3 herë më e lartë se ajo e një viti më parë.

Rritja e detyrimeve financiare përfaqësohet kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte, huamarrjes së linjave të kredive të huaja dhe depozitave të sistemit bankar në bankat dhe institucionet jorezidente.




Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (në mln usd).

Investimet e huaja direkte gjatë tremujorit të katërt vlerësohen rreth 58 milionë dollarë dhe si vit vlerësohen në 220 milionë dollarë amerikanë (rreth 54 për qind më të larta se një vit më parë). Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare.

Borxhi i jashtëm. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive të huaja. Kështu tremujori i katërt regjistroi 25.3 milionë dollarë disbursime, të cilat zënë rreth 51 për qind të periudhës korresponduese një vit më parë.

Në nivel viti disbursimet e borxhit të jashtëm (përfshirë përdorimin e huave dhe kredive në fond prej 12 milionë dollarësh), regjistruan rreth 111 milionë dollarë. Disbursimet kanë shkuar me rreth 86 për qind në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori, rreth 11.8 për qind e totalit të disbursimeve kanë shkuar në favor të sektorit “Autoritet Monetar”. Këto disbursime përfaqësohen kryesisht nga kreditë e Bankës Botërore nëpërmjet Agjensisë së Zhvillimit (IDA).

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë tremujorit të katërt regjistruan rreth 5.8 milionë dollarë. Si vit, shlyerja e detyrimit të borxhit të jashtëm regjistroi rreth 23.4 milionë dollarë dhe u vlerësuan 25.9 për qind më të larta se viti paraardhës.



Grafik 8. DETYRIMET NDAJ KREDITORËVE TË HUAJ.

Detyrimet financiare në formën e *depozitave të jorezidentëve* në sistemin bankar, për tremujorin e katërt janë rritur me 31.1 milionë dollarë amerikanë. Ndryshim të theksuar në këtë tremujor ka pasur edhe në përbërjen e depozitave. Depozitat janë kryesisht në USD dhe në EURO që zënë përkatësisht 32 dhe 58 për qind të totalit të depozitave. Një vend të vogël zënë depozitat në DEM, SFR, LIT dhe GRD me vetëm 11 për qind. Kështu, depozitat në EURO, të cilat në tremujorin paraardhës zinin mesatarisht 2 për qind të depozitave të jorezidentëve, janë rritur gjatë këtij tremujori me 56 pikë përqindjeje, duke arritur pikun e tyre në dhjetor kur zinin 68 për qind të të gjitha depozitave. Kjo është shoqëruar me uljen me 31 pikë përqindjeje të depozitave në USD dhe me 24 pikë të atyre në monedhat kryesore europiane si DEM, SFR, LIT dhe GRD.

Në nivel viti, depozitat e jorezidentëve në sistemin bankar janë rritur me 42 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje vlerësohet rreth 8 herë më e madhe se viti paraardhës. Ndryshe nga viti i kaluar, kur depozitat kanë qenë kryesisht në USD, viti 2001 ndryshoi raportin e depozitave në USD me ato në EURO.

3.2 MJETET FINANCIARE

Mjetet tona jashtë në tremujorin e katërt regjistruan një rritje prej 106 milionë dollarësh ku 87 për qind e zënë mjetet valutore në *cash*. Rritja e këtyre mjeteve ka të bëjë me ndikimin e futjes së Euros në Europë e cila solli:

- prurjen e valutave në sistemin tonë bankar në formën e nënfishave të Euros për t'u konvertuar;
- ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në treg nëpërmjet sistemit bankar për të ruajtur zhvlerësimin e menjëhershëm të Lekut;
- rritjen e të ardhurave nga emigrantët në formë valutash nënfisha të Euros.


Aktivet tona valutore jashtë, në fund të vitit, janë rritur vetëm me 219 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje vlerësohet 3 herë më e lartë se ajo e vitit të kaluar dhe përfaqëson kryesisht rritjen e zotërimeve në mjete valutore të publikut, të cilat vlerësohen me një rritje prej 123 milionë dollarësh, rreth 3 herë më e lartë se rritja e vitit të kaluar.

Depozitat e sistemit bankar, janë rritur me 56 milionë dollarë pas rënies me rreth 1.5 milionë dollarë të vitit të kaluar.

Në rritjen e mjeteve financiare kanë ndikuar edhe investimet e portofolit, të cilat në fund të vitit vlerësohen me një rritje prej 23.4 milionë dollarësh.

4. REZERVAT

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe përdorimi i kredive dhe huave nga FMN) dhe të transfertave korente në *cash* dhe tërheqjen e valutës në treg të Bankës së



Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore. Niveli i rezervave valutore në fund të vitit ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.8 muaj importe (import mallrash). Rritja e importeve si dhe rritja e stokut të rezervës valutore kundrejt një viti më parë, bënë që ky tregues të mbetet në nivelin e vitit 2000. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore me rreth 137 milionë dollarë.